



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1358/2 Prot.

Tiranë, më 30.10. 2025

### V E N D I M

**Nr. 244, datë 30. 10. 2025**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 211 Regj., datë 29.09.2025, të shtetasit N. S, kundër kundër znj. A. Ll., Drejtor i Përgjithshëm të Metrologjisë, znj. E. M., Drejtor i Metrologjisë Ligjore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Bazuar në parashtrimet si dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, z. N. S., ndër të tjera, shprehet se: *Unë jam z. N. S., specialist pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë që nga tetori i vitit 2020 dhe aktualisht vazhdoj të ushtroj këtë funksion. Arsytet që më shtyjnë t’ju drejtohem me këtë letër lidhen me veprime diskriminuese të ndërmarra nga institucioni ku punoj. Konkretisht, pasi jam njohur me vendimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj meje nga Komisioni Disiplinor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, kam kërkuar informacione dhe dokumentacione në funksion të mbrojtjes sime. Në të gjitha kërkesat e mia, Komisioni ka kthyer një përgjigje standarde, duke deklaruar se “kërkesat tuaja nuk janë pjesë e ecures disiplinore”, ndërkohë që shkelja e pretenduar ndaj meje lidhet drejtpërdrejt me këto dokumente dhe informacione të kërkuara.*

*Pretendimet e mia për diskriminim, si specialist, bazohen në sa më poshtë:*

<sup>1</sup> Pa provuar apo dokumentuar se çfarë pretendon a shpjegon ankuesi me këtë shkak.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

1. Trajtim i pabarabartë në përcjelljen e planeve ditore të punës: Gjatë periudhës 01.07.2025 – 25.07.2025, që përkon edhe me shkëljen e pretenduar ndaj meje, specialistëve të Sektorit të Shërbimit Nr. 1 Tiranë u janë dërguar plane pune me kritere preferenciale. Disa prej tyre kanë marrë plane pune pa normë ditore (sipas kërkesave të subjekteve), ndërsa mua më është përcjellë plan pune me numër të caktuar subjektesh për verifikim.

2. Mosmarrja e masave për raste të ngjashme: Ndaj meje, mosrealizimi i planeve ditore gjatë periudhës së sipërpërmendur është cilësuar si “shkelje shumë e rëndë”. Ndërkohë, specialistë të tjerë në të njëjtën situatë nuk janë proceduar disiplinarisht, dhe ndaj tyre nuk është kërkuar largimi nga shërbimi civil. Në ditët kur unë akuzohem për mosrealizim të planeve ditore, siç do të konstatohet edhe në tabelat bashkëngjitur, kam qenë pjesë e grupeve të punës. Përkundër kësaj, asnjë masë nuk është marrë ndaj anëtarëve të tjerë të këtyre grupeve. Gjithashtu, në mbështetje të urdhrin të znj. E. M. (eprrorja ime direkte), të datës 15.07.2025, është kërkuar moskryerja e subjekteve jashtë planit të miratuar ditor të punës (email bashkëngjitur). Megjithatë, disa specialistë kanë vazhduar të kryejnë verifikime jashtë planeve ditore, pa u marrë masa ndaj tyre. Po ashtu, sqaroj se origjina e këtyre subjekteve nuk është mbështetur në bazat e të dhënave të institucionit, por në ato të Qendrës Kombëtare të Biznesit (lista bashkëngjitur). Në këto lista mungojnë të dhëna të sakta mbi adresat, aktivitetin real në terren apo nëse posedojnë instrumenta matës që janë objekt i punës sonë.

3. Pabarazi në kushtet e punës: Për realizimin e procedurave të verifikimit gjatë kësaj periudhe, kërkohet përdorimi i një baze etalonuese me peshë mesatare 15–20 kg (500g në raport me kapacitetin maksimal të peshoreve elektronike), sipas procedurës DPM-ML-PT-02. Megjithëse e kam pasur këtë nevojë për të kryer detyrën time, nuk më është vënë në dispozicion asnjë mjet logjistik nga institucioni. Për pasojë, kam qenë i detyruar të përdor automjetin tim personal. Ndërkohë, specialistëve të tjerë u janë vënë në dispozicion automjete, përkatësisht:

- Specialistëve të verifikimit të dozatorëve dhe parapaketimit – autolaboratorë
- Specialistëve të kontalitrave dhe peshoreve automobilistike – automjete nga drejtoria
- Specialistëve të tjerë të verifikimit – mjete logjistike përkatëse

4. Trajtim preferencial për specialistë të caktuar: Disa specialistë përfitojnë trajtim preferencial, si në përcaktimin e planeve ditore pa norma të qarta, ashtu edhe në ndarjen e instrumenteve për verifikim. Ky trajtim është abuziv, pasi këta persona nuk zotërojnë kualifikime shtesë, trajnime apo njohuri të veçanta në krahasim me mua.

5. Shpërndarje e pabarabartë e detyrave dhe neglizhencë në marrjen e masave: Më 16.07.2025, përmes email-it të punës, më janë dërguar dy plane ditore në orare të ndryshme, me një total prej 21 subjektesh për t’u verifikuar brenda orarit zyrtar të punës. Ky ngarkim tejkapërcen normën e arsyeshme dhe përbën trajtim të pabarabartë.

6. Trajtim i ndryshëm në vlerësimin e detyrave të përmbushura: Më 13.07.2025, në vijim të një kërkesë zyrtare nga eprorja ime përmes email-it, kam përcjellë listën e etaloneve për kalibrim brenda së njëjtës ditë. Megjithatë, kjo është interpretuar si “mosraportim” dhe është përfshirë në dosjen time hetimore. Nëse e njëjta logjikë do të zbatohet në mënyrë të barabartë, edhe specialistë të tjerë do të duhej të ishin propozuar për masa.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri:

- Verifikimi nga ana e Komisionerit për rastin e diskriminimit të ushtruar ndaj z. N. S., nga znj. A. Ll. (titullare e institucionit) dhe znj. E. M. (eprrorja e tij direkte);
- Marrja e masave ligjore përkatëse ndaj personave përgjegjës;
- Anullimi i procedurës disiplinore të ngritur ndaj z. S., pasi kjo procedurë përbën një akt që mbështet diskriminimin dhe cenon të drejtën e tij për trajtim të barabartë në raport me kolegët e tjerë specialistë.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të ankesës dhe akteve bashkëlidhur saj, KMD gjykoi se kjo ankesë duhej plotësuar me informacion shtesë për të mundësuar shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankesë. Për këtë arsye, Komisioneri iu drejtua ankuesit me shkresën nr. 1358/1 prot., datë 30.09.2025, duke kërkuar informacion si më poshtë:

- Shpjegime më të hollësishme në lidhje me shkakun e pretenduar për diskriminim, duke përcaktuar qartë cila është karakteristika, apo veçantia që ju e mbartni dhe që prezumohet të ketë ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese. Ky informacion duhet të shoqërohet me fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë se ju e mbartni këtë shkak të pretenduar.
- Përveç përshkrimit të shkakut, është e nevojshme të sqarohet në mënyrë të qartë se si ky shkak ka ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin që ju konsideroni diskriminues. Ju lutemi të përshkruani lidhjen midis rrethanave të paraqitura dhe pasojave konkrete që keni përjetuar për shkak të tij.
- Informacion nëse, i keni adresuar shqetësimet për diskriminimin tek drejtuesi i institucionit nëse po, ju lutemi të na vini në dispozicion kopje e ankesës si dhe përgjigjen e kthyer nga institucioni.
- Informacion nëse këtë çështje po e ndiqni gjyqësisht; nëse po, na vini në dispozicion kopje të kërkesë-padisë së depozituar pranë gjykatës.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju do e gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj.

Referuar Fletës së Lajmërim-Marrjes të Zyrës Postare nr. RR 790 190 211 AA, datë 30.09.2025, rezultoi se pala ankuese e ka marrë në dorëzim shkresën nr.1358/1 prot., date 30.09.2025 të Komisionerit, por nuk ka dërguar asnjë përgjigje në lidhje me të pranë Komisionerit.

## **III. Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:**

Subjekti ankues është z. N. S., specialist pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë prej tetorit 2020.

Me vendimin për fillimin e ecures disiplinore ndaj tij nga Komisioni Disiplinor i DPM-së, z. S., ka kërkuar dokumentacion në funksion të mbrojtjes, por Komisioni ka refuzuar duke argumentuar se “kërkesat nuk janë pjesë e procedurës disiplinore”.

Ankuesi pretendon se shkelja e pretenduar ndaj tij lidhet drejtpërdrejt me informacionet e kërkuara dhe se ndaj tij është ushtruar trajtim i pabarabartë dhe diskriminues në krahasim me kolegët e tjerë, për sa më poshtë: 1. Plane pune preferenciale janë dërguar vetëm disa specialistëve, ndërsa atij i është ngarkuar plan me normë të caktuar. 2. Mosmarrje masash ndaj specialistëve të tjerë në të njëjtën situatë të pretenduar shkeljeje, edhe pse ata kanë vepruar në kundërshtim me urdhrin zyrtar për moskryerje verifikimesh jashtë planit. 3. Pabarazi në mjetet logjistike, ku z. S., ka përdorur automjetin personal për detyrat e punës, ndërsa specialistë të tjerë kanë pasur automjete në dispozicion nga institucioni. 4. Trajtim preferencial në ndarjen e detyrave dhe llojit të instrumenteve për verifikim, për specialistë pa ndonjë trajnim apo kualifikim shtesë. 5. Ngarkesë joproporcionale pune, si në rastin e datës 16.07.2025, ku i janë dërguar dy plane ditore për 21 subjekte. 6. Trajtim i ndryshëm në vlerësimin e performancës, ku një raportim i kryer në kohë është konsideruar si mosraportim dhe është përfshirë në dosjen hetimore, ndryshe nga kolegët.

Subjekti ankues e konsideron këtë sjellje si diskriminuese dhe në shkelje të parimeve të barazisë në trajtim, dhe kërkon verifikimin e rastit nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe anulimin e procedurës disiplinore të ngritur ndaj tij.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet

me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe të mbrojtura, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, Komisioneri, për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë, të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë vijnë për shkakun e pretenduar, duhet që fillimisht ky shkak të jetë i identifikuar, i provuar dhe i dokumentuar para KMD-së, si një shkak i njohur nga LMD.

Sa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh<sup>3</sup>. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh<sup>4</sup>.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj

---

<sup>3</sup> Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me .....ose me çdo shkak tjetër.”

<sup>4</sup> Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se:

*“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”<sup>5</sup>*

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statute të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”*.

Komisioneri vëren se, “viktimat” e diskriminimit e kanë detyrimin të paraqesin fakte dhe prova nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim apo mbi bazën e të cilave të bëjnë të besueshëm pohimin se është bërë diskriminim.

Pastaj, barra e provës i bartet të paditurit, i cili gjatë zhvillimit të procedurës hetimore duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim, apo se ka pasur arsye ligjore për trajtim të pabarabartë.

<sup>5</sup> Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.



Komisioneri vlerëson se, diskriminimi<sup>6</sup> karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Pala ankuese nuk provon me fakte e prova se mbart shkaqet e pretenduara, sipas përcaktimeve të LMD-së. Në kuptim të LMD-së, *“Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.”*<sup>7</sup>.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes. Kjo pasi, ankuesi nuk ka arritur të provojë apo dokumentojë se çfarë konsideron me “çdo shkak tjetër”, pra se cila është karakteristika e tij individuale, bazuar mbi të cilën Drejtoria e Përgjithshme të Metrologjisë e ka trajtuar në mënyrë të diferencuar.

Në mungesë të provave e fakteve mbi të cilat supozohet se ka pasur diskriminim, pamundësohet vijimi i procedurës për shqyrtimin e ankesës.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...ç) ... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*<sup>8</sup>, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

Komisioneri evidenton faktin se, ankuesi, z. N. S., të gjitha pretendimet që burojnë nga veprimet apo mënyra e administrimit të punës nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, përfshirë organizimin e brendshëm, shpërndarjen e detyrave, kushtet logjistike të punës dhe

---

<sup>6</sup> “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

<sup>7</sup> <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

<sup>8</sup> Për analogji citojmë: Vendimin nr. 163, datë 14.08.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 205, datë 19.10.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 226, datë 06.11.2023, të KMD-së, Vendimi nr. 27, datë 23.01.2024, etj.

masat disiplinore të marra ndaj tij, janë pretendime që lidhen me administrimin e marrëdhënies së punës dhe vlerësimin e performancës nga ana e institucionit. Në mungesë të evidentimit të një shkakut të mbrojtur nga legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimi, këto pretendime nuk hyjnë në juridiksionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por përbëjnë çështje që trajtohen nëpërmjet procedurave të brendshme administrative apo përmes ankimit pranë autoriteteve hierarkike të institucionit, si dhe në rrugë gjyqësore pranë gjykatave kompetente.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç/ të ligjit nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës me nr. 211 Regj., datë 26.09.2025, të subjektit ankues z. N. S., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**